V okviru kontrol oseb na mejnih prehodih Vas bo dne (datum) na mejnem prehodu (kraj) temeljito kontroliral uradnik mejne kontrole s številko službene izkaznice

Prosim, da se pripravite na to, da bo kontrola trajala nekaj časa.

Kontrola lahko obsega posebej naslednje točke:

- kontrola potnih dokumentov glede na pristnost in veljavnost
- kontrola pristnosti in veljavnosti vizuma oz. dovoljenja za bivanje
- kontrola potovalne poti ter namena in trajanja nameravanega potovanja
- preverjanje sredstev, ki so na razpolago za preživljanje za nameravano trajanje in za nameravan namen potovanja
- kontrola glede tiralice
- kontrola glede prekoračitve dovoljenega maksimalnega trajanja bivanja na ozemlju
- kontrola na vaših prevoznih sredstvih in stvari

V vsakem primeru je treba ravnati po navodilih uradnika mejne kontrole.



Shtojca nr. 1/s: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën spanjolle

Hoja de información relativa a la fiscalización en la segunda fase del controle

En el ámbito del controle para la trasposición de frontera, en (fecha)..... en el puesto de transito de frontera (lugar) ejercido por el funcionario/a encargado/a del controle de frontera, con tarjeta de servicio número usted será submetido al siguiente controle:

Por favor, considere que el susodicho controle tardará un poco y podrá abarcar específicamente los siguientes asuntos:

- Verificación de la autenticidad y validez del documento de viaje.
- Verificación de la autenticidad y validez del visado, en particular del título relativo a la permanencia en el País.
- Controle del itinerario del viaje, como también del objetivo y la duración prevista del mismo viaje.
- Verificación de los medios financieros a disposición para la manutención durante el período previsto y para el programado objetivo.
- Controle en la lista de personas señaladas (para busca e/o captura)
- Controle de la eventualidad de haber excedido del periodo máximo de permanencia en el teritorio.
- Controle de sus medios de transporte y sus pertenencias.

Las directivas de las Autoridades del Puesto fronterizo deveran ser obedidas.



Shtojca nr. 1/sh: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën suedeze

Informationsblad beträffande en kontroll i det andra kontrollerdet

Inom ramen av gränsövergångskontroller av personer måste du genomgå den(datum) en ingående kontroll vid gränsövergångsstället(ort) genom gränskontrolltjänstemannen med legitimationsnummret

Vänligen var beredd på att denna kontroll kan vara tidskrävande.

Denna kontroll kan huvudsakligen beröra följande punkter:

- kontroll av resedokumentens äkthet och giltighet
- kontroll av äkthet och giltighet av visum, respektive uppehållstillståndsärendet
- kontroll av reserutten, syfte och vistelsens längd av den planerade resan
- finansiella medel för levnadskostnader för planerad tid och syfte för resan
- kontroll om det finns en efterlysning
- kontroll av överstigande av det maximala uppehållstillståndet
- kontroll av dina transportmedel och tillhörigheter

Anvisningarna av gränskontrolltjänstemännen måste följas till fullo.



Shtojca nr. 1/t: Përmbajtja e dokumentit në gjuhën turke

İkinci kontrol hattındaki kontrol ile ilgili bilgi formüleri

Kisilerin sınır geis kapılarında kontrolleri çerevesinde, (data) tarihinde (PKK) sınır geis kapısında görev kimlik numarası olan sınır kontrol memuru tarafından geniş kapsamlı bir kontrole tabi tutulacaksınız.

Lütfen bu kontrolün belirli bir süre devam edeceğini göz önünde bulundurunuz.

Bu kontrol özellikle aşağıdaki hususları içerebilir:

- Seyahat belgelerinin gerçek olup olmadıklarının ve geçerlilik sürelerinin kontrolü
- Vizenin ya da oturma izninin gerçek olup olmadığının ve geçerlilik süresinin kontrolü
- Seyahat güzergahının ve öngörülen yolculuğun amacının ve süresinin kontrolü
- Yolcunun üzerindeki para ve diğer mali kaynakların yolculuğun amacı ve öngörülen süresi göz önünde bulundurulduğunda geçimini sağlamaya yeterli olup olmadığını kontrolü
- Yolcunun aranıp aranmadığının kontrolü
- İzin verilen azami ikamet süresinin asılıp asılmadığının kontrolü
- Ulaşım araçların ve eşyaların kontrolü

Her durumda sınır kontrol memurunun talimatlarına uyulması gerekmektedir



Shtojca nr. 2: Shembulli i dokumentit të lëshuar në 2 gjuhë.

Faqe 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____
Pika e Kalimit Kufitar _____

Nr. _____ Prot. _____, më _____.20__

Drejtuar: Z. / Zj. _____

Formular informacioni për verifikim të detajuar në vijën e dytë

Në kuadër të verifikimit kufitar të personave që kalojnë kufirin, ju do t'i nënshtroheni tani, më datë _____, në PKK _____, një verifikimi të hollësishëm nga roja kufitare me numër identifikimi _____.

Ky verifikim mund të marrë kohë. Ju lutemi, jini të përgatitur për këtë fakt.

Ky verifikim mund të përfshijë veçanërisht pikat e mëposhtme:

- Verifikimin e dokumenteve tuaja të udhëtimit për të vlerësuar origjinalitetin dhe vlefshmërinë e tyre;
- Verifikimin e vizës suaj ose dokumentit që mundëson qëndrimin tuaj, për të vlerësuar origjinalitetin dhe vlefshmërinë e tyre;
- Verifikimin e itinerarit, si dhe të qëllimit dhe të kohës së qëndrimit për udhëtimin e synuar nga ana juaj;
- Verifikimin e mjeteve të jetesës që zotëroni për të mbuluar shpenzimet që rrjedhin nga kohëzgjatja dhe qëllimi i udhëtimit të synuar nga ju;
- Verifikimin nëse ekziston ndonjë shënim ose njoftim;
- Verifikimin për t'u siguruar se nuk keni kapërcyer kohën maksimale të afatit të lejuar të qëndrimit në territor;
- Verifikimin e sendeve dhe mjetit tuaj të transportit;

Çdo udhëzim i dhënë nga rojet kufitare duhet të zbatohet në secilin hap.

Përgjegjës Turni

N/Komisar _____(Emër)_____(Mbiemër)_____
(Firmë)
(Vulë)

Adresa: _____



Faqe 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Policisë së Shtetit

Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

Pika e Kalimit Kufitar _____

Nr. _____ Prot. _____, më _____.20__

Drejtuar: Z./Zj. _____

Information sheet on thorough second line check

You shall now undergo a thorough check as part of a border check on persons conducted at the border crossing point _____, on _____, by the border guard with the service identification number _____.

This check could take quite some time. Please prepare yourself for this fact.

This check may include the following point in particular:

- Check on your travel documents to determine whether they are genuine and valid;
- Check on your visa or the document authorising your stay to determine whether it is genuine and valid;
- Check on your travel route and on the purpose and duration of your intended trip;
- Check on the means of subsistence you have available to you to cover living expenses for the intended duration and purpose of your trip;
- Check whether an alert is issued;
- Check to be sure that you did not exceed the maximum duration of authorized stay in the territory;
- Check on your means of transport and belongings;

Any instruction issued by the border guards must be obeyed in each instance.

Përgjegjës Turni

N/Komisar (Emër) (Mbiemër) _____

(Firma)

(Vula)

Adresa: _____

**UDHËZIM****Nr. 5166, datë 20.10.2016****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE TË TJERA SHITESË
NË SQARIM TË KRITEREVE TË
PARASHIKUARA NË NENIN 133, SI DHE
PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE
PROCEDURËS SË MARRJES SË
LICENCËS OSE RIPËRTËRITJEN E SAJ,
NË BAZË TË NENIT 134, TË LIGJIT NR.
35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË
DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT
E TJERA TË LIDHURA ME TO”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës dhe nenit 158, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

UDHËZOJ:**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****A. Qëllimi i udhëzimit**

1. Nëpërmjet këtij udhëzimi përcaktohen kriteret profesionale, të cilat duhet të përmbushen nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv (këtej e tutje “AAK-të”) dhe procedurën e mbajtur nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit (këtej e tutje “DDA”), për marrjen e licencës apo ripërtëritjes së saj nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, në ushtrimin e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

2. Kriteret dhe procedura shitesë e këtij udhëzimi janë në sqarim dhe në bazë të neneve 133 dhe 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

B. Kriteret profesionale

Për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, AAK-ja, duhet të ketë:

1. Selinë e saj të ushtrimit të veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë;

2. Kushte të përshtatshme me pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj;

3. Ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel

kombëtar dhe ndërkombëtar, gëzimin e mekanizmave të mjaftueshëm për mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve kundrejt anëtarëve titullarë të të drejtave, ekspertizën profesionale me të paktën një punonjës jurist dhe me njohuri të gjuhëve të huaja;

4. Një ekspertizë profesionale me një punonjës me njohuri në fushën financiare dhe të kontabilitetit;

5. Punonjësit e Agjencive të Administrimit Kolektiv me njohuritë e parashikuara në pikat 3 dhe 4, më sipër, të këtij kreu; punonjësit që kryejnë detyrat e inspektimit në bazë dhe për zbatim të ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe ligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” janë të detyruar të kenë kryer studimet në nivel Bachelor ose Master për pronësinë intelektuale brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Mospërmbushja e kësaj pike, pas kalimit të afatit 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit, përbën kusht për pezullimin e licencës deri në përmbushjen e këtij kriteri profesional;

6. Kualifikimet profesionale dhe njohja e gjuhëve të huaja, të përmendura në pikat më sipër, duhet të vërtetohen me dëshmitë përkatëse.

C. Kontraktimi për kryerje të funksioneve dhe shërbimeve specifike

1. AAK-ja mund të pajtojë për kryerjen e ndonjë funksioni ose asistencë administrative, teknike specifike ose që ndihmon funksionimin normal të saj, një person tjetër fizik ose juridik. Në çdo rast, subjektet në fjalë duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në ligj për kryerjen e punëve të tilla dhe në çdo rast punonjësi duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. AAK-ja, në përputhje me nenin 136, pikat 2 dhe 3, të ligjit “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” do të konsiderohet se i plotëson kriteret në lidhje me shërbimet e saj teknike dhe logjistike edhe nëse funksionet ose asistencën administrative, teknike specifike, brenda fushës së aktiviteteve të saj, që kanë të bëjnë me administrimin e të drejtave përkatëse, do të kryhen nga shërbimet teknike dhe logjistike të një AAK-je tjetër, e cila është pajisur nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, për administrimin e një kategorie të caktuar të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Të gjitha të drejtat



dhe detyrimet mes dy Agjencive të Administrimit Kolektiv do të rregullohen nëpërmjet një kontrate/marrëveshje të miratuar nga organet vendimmarrëse të tyre në mënyrë respektive, duke marrë parasysh shkurtimin e kostove dhe administrimin me efikasitet dhe rentabilitet të këtyre agjencive. Në çdo rast, në bazë të këtij ligji, çdo agjenci ka detyrimin të kryejë me mjetet dhe shërbimet teknike e logjistike të veta shpërndarjen e të ardhurave të mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, për çdo vit kalendarik përkatës.

KREU II KËRKESA PËR LICENCIM OSE RIPËRTËRITJEN E SAJ

A. Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa për licencim ose ripërtëritje të licencës për Agjencinë e Administrimit Kolektiv, për kryerjen e veprimtarisë së përmendur në kreun I, germa “A” të këtij udhëzimi, duhet të përmbajë:

a) emrin dhe vendin ku AAK-ja do të ketë selinë e saj;

b) një ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjiale;

c) përshkrimin e kategorisë përkatëse të të drejtave të autorit ose të të drejtave të tjera të lidhura me to, që synon të administrojë në emër të mbajtësve të të drejtave, mbajtësit e të drejtave të autorit/lidhura me to;

ç) statutin e agjencisë sipas parashikimeve të ligjit mbi OJF-të dhe rigorozisht të përfshijë në mënyrë specifike parashikimet e ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

d) të gjithë dokumentacionin dhe dëshmitë, parashikuar në kreun I të këtij udhëzimi, për punonjësit që do të jenë pjesë administrative e AAK-së, që vërteton kualifikimet e tyre profesionale, përvojën profesionale dhe njohuritë e gjuhëve të huaja.

2. Kërkesa e përmendur në pikën 1 të këtij kreu, duhet të shoqërohet me:

a) një listë të anëtarëve në bazë të të drejtave të autorizuar prej tyre;

b) kontrata për përfaqësim reciprok të nënshkruara me agjencitë e huaja.

3. Në rastin e përmendur në pikën 1, germa “C”, kreu I, i këtij udhëzimi, kërkesa duhet të

shoqërohet me kontratën me personin fizik ose juridik, si dhe dokumentacionin që provon se personi i plotëson kriteret e përcaktuara ligjore dhe parashikimet e këtij udhëzimi.

4. Në rastin e përmendur në pikën 2, germa “C”, kreu I, i këtij udhëzimi, kërkesa duhet të shoqërohet me kontratën/marrëveshjen me agjencinë tjetër të administrimit kolektiv, e cila është pajisur tashmë nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, për administrimin e një kategorie të caktuar të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

5. Të dhënat shoqëruese të përmendura në pikën 2, germa “A”, kreu II, të këtij udhëzimi, mund të paraqiten në formë elektronike.

6. Përveç sa parashikohet në këtë udhëzim për kërkesën për licencim ose ripërtëritje të saj, AAK-ja plotëson edhe formularin e aplikimit për licencim ose ripërtëritje të saj të administrimit kolektiv për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Formulari miratohet nga drejtori i Drejtorisë së të Drejtës së Autorit pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, në zbatim të kriterëve të ligjit për të drejtën e autorit dhe këtij udhëzimi, si dhe do të shërbejë për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të AAK-së.

7. Pas datës së plotësimit të dosjes së paraqitur për licencë ose ripërtëritje të saj nga një AAK, në zbatim të nenin 134/2, të ligjit për të drejtën e autorit, Drejtoria e së Drejtës së Autorit njofton nëpërmjet një thirrjeje publike, në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit edhe subjekte të tjera të mundshme, të cilat mund të kenë interes për pajisje me licencë për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Ky afat për depozitimin e kërkesave të reja dhe plotësimin e plotë të dosjes së aplikimit për licencim është 20 ditë kalendarike.

8. Drejtoria e së Drejtës së Autorit mban të dhënat dhe dosjen e aplikimeve të agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave.

B. Dhënia e licencës ose ripërtëritjes së saj

1. Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit do të pajisë me licencë ose ripërtëritje të saj, në zbatim të neneve 133 dhe 157, pika 2, germa “ë”, të ligjit për të drejtat e autorit, vetëm ato AAK që krijohen në përputhje me ligjin për OJF-të, dhe që plotësojnë rigorozisht kriteret e ligjit “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.



2. Në rastet e shqyrtimit të kërkesës për ripërtëritje të licencës nga ana e AAK-së, Drejtoria e së Drejtës së Autorit pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, do të vlerësojë:

a) historikun e administrimit të bërë nga agjencia në fjalë për kategorinë përkatëse për të cilën është pajisur me licencë;

b) performancën e saj në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve për anëtarët e tyre;

c) performancën e saj në lidhje me shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës;

ç) mënyrën e funksionimit të brendshëm dhe respektimit të akteve rregulluese individuale dhe kolegjiale në raport me anëtarësinë;

d) raportimin dhe përmbushjen e detyrave nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit;

dh) respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/kontratë përfaqësimi;

e) transparencën e bilanceve, informacionit dhe raportimit me organet e tjera shtetërore;

f) përmbushjen/zbatimin e parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit për ushtrimin e administrimit kolektiv dhe legjislacionit në fuqi.

3. Pas botimit në Fletoren Zyrtare të urdhrit të ministrit për licencimin ose ripërtëritjen e saj të një AAK-je, agjencia është e detyruar të kryejë pagesën në përputhje me nenin 157/4, të ligjit për të drejtat e autorit dhe me VKM-në përkatëse të tarifave të shërbimeve që kryhen nga DDA-ja dhe ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.

4. Në rast moslicencimi ose ripërtëritje të saj, kërkuar ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

C. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR

Nr. 6915, datë 17.10.2016

PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE RREGULLAT E PAJISJES E ADMINISTRIMIT TË VULAVE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 15 dhe 39, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes e vulave zyrtare”,

URDHËROJ:

1. Përmbarruesi gjyqësor privat paraqet kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë, për pajisjen me vulën e njomë, pas certifikimit nga ministri i Drejtësisë dhe marrjes së aktit administrativ përkatës nga Qendra Kombëtare e Biznesit për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Pajisja e përmbarruesve gjyqësorë privatë me vula bëhet nga Ministria e Drejtësisë brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

3. Certifikimi si përmbarrues gjyqësor privat lëshohet vetëm për individë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, vula që lëshohet për ta është personale dhe përdoret vetëm nga përmbarruesi gjyqësor privat, si dhe vendoset në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij profesionale.

4. Pavarësisht se shërbimi përmbarrimor mund të ofrohet nëpërmjet një subjekti tregtar, vula është personale dhe përdoret vetëm nga përmbarruesi i pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përmbarruesit gjyqësor privat.

5. Veprimet përmbarrimore kryhen vetëm nga individë të pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përmbarruesit gjyqësor privat dhe nën përgjegjësinë vetjake të tyre.

6. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t’u jepet në asnjë rrethanë të tretëve. Në rast se gjatë kontrolleve, konstatohet se vula e përmbarruesve gjyqësorë privatë përdoret nga persona të tretë ose nga subjekti tregtar ku përmbarruesi ushtron



funksionin, ky fakt përbën shkelje të rëndë në veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar.

7. Vula e njomë ka formë rrethore, me diametër 35 mm. Brenda saj shkruhen në formë harkore me shkronja kapitale fjalët “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” dhe poshtë tyre me shkronja kapitale më të vogla shkruhet në një rresht të dytë emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i përmbaruesit gjyqësor privat. Në mes konturohet shqiponja dykrenore dhe poshtë saj, në formë harkore në të kundërt të emrit dhe mbiemrit të përmbaruesit janë shkruar me shkronja kapitale, por në të njëjtën madhësi me ato të emrit, fjalët “PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT”.

8. Ministria e Drejtësisë i paraqet kërkesën për përgatitjen e vulave subjekteve shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur subjekteve private shqiptare ose të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente. Emrat e tyre miratohen paraprakisht nga ministri i Drejtësisë. Përmbaruesi gjyqësor privat paguan paraprakisht tarifën të subjekti që përgatit vulën.

9. Vulat dorëzohen në Ministrinë e Drejtësisë nga subjekti përgatitës i tyre. Vulat merren në dorëzim me procesverbal, të nënshkruara nga përfaqësuesi/t e përmendur më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Ministrisë së Drejtësisë. Struktura e Ministrisë së Drejtësisë njofton përmbaruesin që të paraqitet për marrjen në dorëzim të vulës. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga personi i autorizuar nga ministri i Drejtësisë dhe nga përmbaruesi gjyqësor privat. Në procesverbal shënohet koha, vendi, emrat e pjesëmarrësve, si dhe fakti i marrjes së vulës në dorëzim nga përmbaruesi privat. Procesverbali hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga personat e lartpërmendur, ku secili mban një kopje të tij.

10. Institucioneve qendrore më të rëndësishme, si dhe subjekteve të tjera që vlerësohen nga ministri i Drejtësisë se kanë lidhje të ngushtë me veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë privatë u dërgohet zyrtarisht, për çdo përmbarues gjyqësor privat, një fletë e bardhë e nënshkruar dhe e vulosur me vulën e tij.

11. Në çdo rast, modeli i vulave, emri dhe firma e çdo përmbaruesi gjyqësor privat i dërgohet për depozitim e model Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Bankës së Shqipërisë, si dhe bankave të nivelit të dytë, Qendrës Kombëtare të Biznesit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, prokurorive, gjykatave, si dhe çdo institucioni tjetër publik/privat, me kërkesë të tij.

12. Vulat e përmbaruesve gjyqësorë privatë, që nuk e ushtrojnë më detyrën, në përputhje me nenin 21, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, tërhiqen nga Ministria e Drejtësisë.

13. Përmbaruesi, i cili kërkon të pezullojë veprimtarinë e tij dhe që është pajisur me vulë, duhet të dorëzojë për asgjësim në Ministrinë e Drejtësisë vulën e tij. Procesverbali dokumenton dorëzimin dhe asgjësimin, hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e strukturës së ngarkuar nga ministri i Drejtësisë dhe nga përmbaruesi gjyqësor privat, ku secili mban një kopje të tij.

14. Përmbaruesi, i cili kërkon të rifillojë veprimtarinë përmbarimore, duhet të paraqesë kërkesë, për pajisjen me vulë të re, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë rast, zbatohen rregullat e parashikuara në këtë urdhër për marrjen në dorëzim të vulës.

15. Në rastet e tjera, për asgjësimin e vulës, zbatohen rregullat e parashikuara në pikën 13, të këtij urdhri.

16. Në rastet e përmbaruesve gjyqësorë privatë, të cilët janë organizuar si subjekte tregtare/shoqëri përmbaruese dhe disponojnë vula vetëm në emër të shoqërisë përmbarimore, të marrin masat e nevojshme për dorëzimin e vulave të lëshuara në emrin e shoqërive/subjekte përmbaruese dhe të pajisen me vulat personale të lëshuara nga Ministria e Drejtësisë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri. Me mbarimin e këtij afati, vulat e vjetra deklarohen të pavlefshme. Për asgjësimin e këtyre vulave zbatohen rregullat e parashikuara në pikën 13, të këtij urdhri.

17. Për vulat e deklaruara të pavlefshme dhe të asgjësuar, Ministria e Drejtësisë vë në dijeni institucionet e përcaktuara në pikën 11, të këtij urdhri, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe se



dokumentacioni i paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat, duhet konsideruar i pavërtetë.

18. Kur përmbaruesi, i cili është çregjistruar nga regjistri në Ministrinë e Drejtësisë, nuk dorëzon vulën, Ministria e Drejtësisë vë në dijeni institucionet, të cilave u është dërguar modeli i vulës së përmbaruesit dhe firma e tij, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe dokumentacioni i paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat, duhet konsideruar i pavërtetë.

19. Përdorimi i vulave të deklaruara të pavlefshme e bën dokumentacionin përkatës të pavlefshëm dhe përbën shkak për procedim sipas legjislacionit në fuqi.

20. Urdhri nr. 4846/18, datë 20.9.2010, i ministrit të Drejtësisë, “Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e pajisjes e administrimit të vulave të përmbaruesve gjyqësor privatë”, shfuqizohet.

21. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë të orientojë përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe subjektet tregtare/shoqëritë përmbaruese të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

22. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

KËRKESË

Nr. 2503/10, datë 21.10.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i shëtitores “Ali Pasha”, restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”, në Bashkinë e Tepelenës.

Subjekti kërkues është Bashkia e Tepelenës. Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 2 013 023 (dy milionë e trembëdhjetë mijë e dyzet e tre) lekë.

ZËVENDESMINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të

“Rikonstruksionit të shëtitores “Ali Pasha”, restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”, në Bashkinë e Tepelenës.

Nr	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja m ² , ndëtrim	Vlera në lek	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Kastriot Hysa	10/76-Nj	3574	51.1	941335	Konfirmim nga ZRPPP
2	Erald Alike	10/76-Nj	3574	51.7	847360	Konfirmim nga ZRPPP
3	Fatmir Seiti	10/76+1-1	3574	125.1	224328	Konfirmim nga ZRPPP
	Totali				2 013 023	

**KËRKESË****Nr. 4391/7, datë 21.10.2016****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim, sistemim dhe asfaltim i rrugëve dhe trotuareve”, në Bashkinë e Hasit.

Subjekti kërkues është Bashkia e Hasit. Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së

shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 1 074 183 (një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË
BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të
“Ndërtim, sistemim dhe asfaltim të rrugëve dhe trotuareve”, në Bashkinë e Hasit.

Nr	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja m ² truall	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lek	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Agim Azem Geca	4/167	2282	473	2271	1074183	Konfirmim nga ZRPPP
Totali						1 074 183	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë